

20101713705

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHPALLJEN E ÇARSHISË SË
VJETËR TË SHKUPIT TRASHËGIMI KULTURORE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

Neni 1

Në Ligjin për shpalljen e Çarshisë së Vjetër të Shkupit trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2008) neni 6 ndryshohet si vijon:

"Për mbrojtjen, rregullimin, revitalizimin dhe shfrytëzimin racional të Çarshisë së Vjetër të Shkupit, miratohet një plan urbanistik për tërë sipërfaqen e kompleksit monumental.

Plani nga paragrafi 1 i këtij neni përpilohet në mbështetje të bazave mbrojtëse konservatore, të përgatitura nga institucioni publik kompetent për mbrojtje.

Bazat mbrojtëse konservatore për kompleksin monumental Çarshia e Vjetër e Shkupit, detyrimisht përmbajnë masa të lejuara dhe restriktive për çdo pjesë përbërëse të veçantë në kompleksin monumental Çarshia e Vjetër e Shkupit.

Bazat e lejuara mbrojtëse konservatore nga paragrafi 2 i këtij neni inkorporohen në planin nga paragrafi 1 i këtij neni, në pajtim me rregullat e planifikimit urbanistik, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe këtë ligj.

Planin nga paragrafi 1 i këtij neni e miratojnë komuna e Qendrës dhe Çairit në procedurë të përcaktuar me ligj.

Plani nga paragrafi 1 i këtij neni nevojitet që të harmonizohet me Programin nga neni 11 i këtij ligji."

Neni 2

Në nenin 10 paragrafi 2 në fjalinë hyrëse të fjala "dhjetë" zëvendësohet me fjalën "njëmbëdhjetë".

Pas pikës 10 shtohet pikë e re 11, si vijon:

"11) një përfaqësues nga Qyteti i Shkupit."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".